



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	24.06.2026	13.07.2026	2026/0402
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Sezair Ruhani	25.06.2026		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.06.2026, OE “MEDPLUS SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0402, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekesore per Barnatoren Qendrore te QKMF-se” me nr. të prokurimit: "635-26-957-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues-teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Neni 1 i LPP-së
 Neni 6 i LPP-së
 Neni 7 i LPP-së
 Neni 59 i LPP-së
 Neni 60 i LPP-së
 Neni 69 i LPP-së
 Neni 72 i LPP-së
 Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
 Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
 Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
 Neni 14 i LIGJ PËR ÇMIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE.

KRITERET PËR VLERËSIM

			vetëm e qyte.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK)	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje

		Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH –së	
		Kërkesa 3. Kopja e Liqences së AKPPM-së si qarkulluese me shumicë të produkteve dhe pajisjeve medicinale	Evidenca 3 Kopja e Licences së AKPPM-së
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjat tre vite të fundit financiare duhet të jetë jo më pak se 450.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Deklarata dorëzuara në Administratën Tatimore Kosovës apo në vendin e themelimit e raporteve financiare dhe raporteve menagjimit të certifikuara nga një firmë njohur e licencuar për kontrollim nga auditor i licencuar i pavarur

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “MEDPLUS SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së” me numër të prokurimit: “635-26-957-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajeshme per furnizim në vler prej 350.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.	Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.
		Kërkesa 2 Autorizim nga prodhuesi apo dileri i Autorizuar nga Prodhuesi	Dëshmia 2 Autorizimi nga prodhuesi apo dileri i autorizuar nga prodhuesi per shitjen e produkteve (per poz 34,68,69)
		Kërkesa 3 Operatori ekonomik te ofroje Certifikata nga prodhuesi -ISO certifikat nga prodhuesi -CE Certifikat nga prodhuesi	Dëshmia 3 ISO certifikat nga prodhuesi (per poz 34,68,69) CE Certifikat nga prodhuesi (per poz 34,68,69)
		Kërkesa 4 Dorzimi i mostrave për materialet e kerkuara sipas paramases dhe specifikimit teknik.	Dëshmia 4 Për <u>produktë me</u> (poz34,68,69) kërkohet nga një mostër te Aneksi 1 Te Specifikimi Teknik ,mostrat duhen të sillen ne kopje fizike para hapjes se ofertave.
			Vërejtje

			Mostrat duhen te sillen ne zyren e prokurimit ne ditën e hapjes para ores 12 00
--	--	--	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “MEDPLUS SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së” me numër të prokurimit: “635-26-957-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA	KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEČ										
ZYRA E PROKURIMIT KOMUNA E PEJËS											
NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES <i>Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik</i>											
Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së											
<table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%;">Nr. i prokurimit¹</td> <td>635-26-957-1-1-1</td> </tr> <tr> <td>Nr i brendshëm</td> <td>635-26-008-111</td> </tr> </table>	Nr. i prokurimit ¹	635-26-957-1-1-1	Nr i brendshëm	635-26-008-111							
Nr. i prokurimit ¹	635-26-957-1-1-1										
Nr i brendshëm	635-26-008-111										
<table border="1" style="width: 100%;"> <thead> <tr> <th style="width: 10%;">Radhë</th> <th style="width: 60%;">Lënda / grupi: Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së</th> <th style="width: 30%;">Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (me TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1.</td> <td>MEDPLUS SH.P.K.</td> <td>57.37</td> </tr> <tr> <td>2.</td> <td>Grup i Operatorëve Ekonomik BRT Pharm SH.P.K.; N.SH.T NERAMED</td> <td>167.07</td> </tr> </tbody> </table>			Radhë	Lënda / grupi: Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së	Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (me TVSH)	1.	MEDPLUS SH.P.K.	57.37	2.	Grup i Operatorëve Ekonomik BRT Pharm SH.P.K.; N.SH.T NERAMED	167.07
Radhë	Lënda / grupi: Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së	Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (me TVSH)									
1.	MEDPLUS SH.P.K.	57.37									
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik BRT Pharm SH.P.K.; N.SH.T NERAMED	167.07									
Rezultati i aktivitetit të prokurimit: <u>KOMUNA E PEJES ANULON A.P</u> Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës njofton se ka vendosur të anulojë këtë aktivitet të prokurimit, pasi është konstatuar se asnjë Operator Ekonomik nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (FDT).											
Data: 05.06.2026											
Menaxheri i Prokurimit Milot Gashi 											

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

OSHP: 2026/0186

OSHP: 2026/0284

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **MEDPLUS SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 dhe 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është njoftuar nga autoriteti kontraktues me Vendimin (B58), ku AK e anulon në tërësi aktivitet e prokurimit **Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së**. OE ankues eliminohet me arsyetimin se cmimet e ofruara janë abnormalisht të uleta dhe arsyeja e dyte e eliminimit ka të bëjë me specifikimet teknike të produktit.

ARSYETIM PËR ELIMINIM – ÇMIM ABNORMALISHT I ULËT DHE MOSPËRPUTHSHMËRI ME SPECIFIKIMET TEKNIKE

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar ofertën e Operatorit Ekonomik në përputhje me nenin 6.1.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), të cilat rregullojnë trajtimin e ofertave çmime abnormalisht të ulëta.

1. Vlerësimi i ofertës financiare – çmim abnormalisht i ulët

Pas analizimit të ofertës financiare, është konstatuar se Operatori Ekonomik ka ofertuar çmime dukshëm më të ulëta krahasuar me vlerën e parashikuar dhe strukturën e çmimeve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Konkretisht, për 69 pozicionet e paramasës dhe parallogarisë, vlera e përlogaritur nga Autoriteti Kontraktues është 556.22 €, ndërsa oferta e dorëzuar nga Operatori Ekonomik është 120.42 €. Kjo paraqet një devijim prej 435.80 €, përkatësisht rreth 78.37% më të ulët se vlera e parashikuar..

Diferenca e konsiderueshme ndërmjet vlerës së parashikuar dhe ofertës së paraqitur përbën devijim theksuar nga nivelet e pritshme të tregut dhe ngre dyshime serioze lidhur me realizueshmërinë e kontratës, aftësinë për furnizim sipas specifikimeve të kërkuara dhe mbulimin e kostove reale të tregut.

Komisioni Vlerësues ka analizuar çmimet për secilin pozicion dhe ka konstatuar se në të gjitha pozicionet, çmimet e ofruara janë dukshëm më të ulëta se çmimet referuese të tregut për produkte karakteristika të njëjta ose të ngjashme. Rrjedhimisht, këto çmime nuk reflektojnë një strukturë reale ekonomike të kostove të furnizimit.

Për rrjedhojë, Komisioni Vlerësues vlerëson se oferta përmban çmime abnormalisht të ulëta, të cilat nuk janë të justifikuara në përputhje me nenin 61.1 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Bazuar në këto gjetje, oferta e Operatorit Ekonomik konsiderohet e papërgjegjshme dhe refuzohet.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyetimin e pare të eliminimit të autoritetit kontraktues, vlerëson se nuk qendron, sepse nuk mund të merret parasysh dhe të krahasohet vlera e parashikuar me çmimin e ofruar për një ose disa produkte. Në rastin konkret AK ka deklaruar se për 69 pozicione të paramasës dhe parallogarise, vlera është 78.37% më e ulët se vlera e parashikuar. Dispozitat ligjore të nenit 61 të LPP-se, parashohin një procedurë të cilën autoriteti kontraktues duhet ta zbatojë dhe në fund të konstatojë për çmimin e ofruar nga një operator ekonomik dhe nuk mund të krahasohet me vlerën e parashikuar të kontratës. Prandaj, pretendimi i OE ankues qendron.

OE ankues, në ankesën e tij, ka pretendime lidhur me ofertën e dyte pjesmarrese, lidhur me çmimet e ofruara, deklaratën në betim, marrëveshjen e konzorciumit të OE BRT Pharm&Neramed. Eksperti shqyrtues, sqaron se të njëjtat pretendime edhe autoriteti kontraktues i ka cekur në letren standarde të tenderuesit të eliminuar OE BRT Pharm&Neramed, pra i njëjti është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se i njëjti nuk ka parashtruar ankese në OSHP, nuk ka shprehur interesim për

këtë aktivitet të prokurimit, prandaj trajtimi i këtyre pretendimeve është i panevojshëm.

Sa i perket arsyes së dyte të eliminimit të OE ankues, i cili eliminohet me arsyetimin se:

2. Vlerësimi teknik – mosplotësim i specifikimeve (Pozicioni 68)

Autoriteti Kontraktues, gjatë fazës së vlerësimit teknik të ofertave dhe mostrave të dorëzuara, ka shqyrtuar produktin e ofruar nga Operatori Ekonomik për pozicionin 68, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për pozicionin 68 është kërkuar furnizimi me dezinfektues për duar, ku në 100 g tretësirë duhet të përmbahen së paku 89.1 g Etanol 96% si përbërës aktiv. Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se këto specifikime përbëjnë kërkesat minimale të pranueshmërisë dhe çdo produkt duhet t'i plotësojë ato ose t'i tejkalojë.

Nga shqyrtimi i mostrës së dorëzuar dhe dokumentacionit teknik përkatës, është konstatuar se Operatori Ekonomik ka ofertuar produktin “AHD 2000 G – Hygienic and Surgical Hand Disinfectant”, i cili sipas etiketës dhe të dhënave të prodhuesit përmban 75 g etanol në 100 g produkt, përkatësisht 75%.

Krahasimi i drejtpërdrejtë ndërmjet specifikimit të kërkuar dhe produktit të ofruar tregon qartë se përmbajtja e etanolit është dukshëm më e ulët se minimumi i kërkuar prej 89.1 g/100 g.

Duke qenë se kërkesa teknike përbën kusht minimal dhe detyrues për pranueshmërinë e ofertës, çdo devijim nën këtë nivel konsiderohet mospërputhje materiale me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret, produkti i ofruar nuk përmbush kërkesën minimale dhe nuk paraqet as specifikim ekuivalent apo më të avancuar.

Përmbajtja e etanolit është element thelbësor për efektivitetin e produktit dezinfektues, dhe mosplotësimi i këtij kriteri përbën devijim substancial nga kërkesat teknike të përcaktuara.

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit, oferta e Operatorit Ekonomik për pozicionin 68 nuk i përmbush kërkesat minimale teknike dhe konsiderohet ofertë e papërgjegjshme.

Përfundim

Bazuar në të gjitha gjetjet e mësipërme, si në aspektin financiar (çmim abnormalisht i ulët) ashtu edhe në aspektin teknik (mosplotësim i specifikimeve minimale), oferta e Operatorit Ekonomik refuzohet në tërësi si ofertë e papërgjegjshme.

Konstatimet nga Eksperti teknik

Përshkrimi i pretendimit

OE ankues kundërshton bazën e dytë të eliminimit – mospërmbushjen e specifikimit teknik për pozicionin 68 (dezinfektues për duar me së paku 89.1 g Etanol 96% në 100 g tretësirë).

Ankuesi ka ofertuar produktin "AHD 2000 G – Hygienic and Surgical Hand Disinfectant" me 75 g etanol në 100 g produkt dhe pretendon se ky produkt është **ekuivalent** me atë të kërkuarin, duke u thirrur në vendimin paraprak të panelit shqyrtues të OSHP-së nr. 186/26 të dt. 21.04.2026, i cili e detyroi AK-në të lejojë ekuivalencën për këtë pozicion.

Në mbështetje të ekuivalencës, ankuesi paraqet ekspertizën e ekspertit gjyqësor – farmacist, specialist i toksikologjisë dhe barnave – të dt. 08.06.2026, sipas së cilës produkti i ofruar mund të konsiderohet i barasvlefshëm në aspektin teknik dhe përdorues, si dhe udhërrëfyesin e OBSH-së për higjienën e duarve, sipas të cilit formulimet me 60–80% etanol janë efektive dhe përqendrime më të larta janë më pak potente. Ankuesi pretendon se AK ka analizuar vetëm aspektin sasior e jo atë cilësor të produktit dhe nuk e ka përfillur vendimin e OSHP-së për ekuivalencën.

Vlerësimi i ekspertit teknik

Së pari, sa i përket fuqisë së vendimit nr. 2026/0186: nga shkresat e lëndës rezulton se ai vendim e detyroi AK-në të lejojë **ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar**, detyrim të cilin AK e zbatoi me korrigjimin e Dosjes së Tenderit përmes formularit B54 të dt. 23.04.2026, ku për pozicionin 68 u përcaktua vlera prej së paku 89.1 g Etanol 96% në 100 g tretësirë si **kërkesë minimale e pranueshmërisë**. Lejimi i ekuivalencës nuk nënkupton heqjen apo uljen e minimumit të kuantifikuar; ai nënkupton se çdo produkt – pavarësisht emrit tregtar apo prodhuesit – pranohet nëse e arrin ose e tejkalon atë vlerë. Produkti i ofruar me 75 g/100 g qëndron objektivisht rreth 16% nën minimumin e kërkuar dhe, për vetë natyrën sasiore të parametrit, nuk mund të cilësohet as ekuivalent e as më i avancuar.

Së dyti, ligjshmëria e vetë specifikimit është **çështje e gjykuar**. Ankuesi e ka kontestuar dy herë kërkesën teknike të pozicionit 68: fillimisht me ankesën nr. 2026/0186 (e aprovuar pjesërisht, me detyrimin e lejimit të ekuivalencës, tashmë të zbatuar), e më pas me ankesën nr. 2026/0284, ku pretendoi se vlera 89.1 g favorizon një prodhues të caktuar – ankesë të cilën paneli shqyrtues i OSHP-së e refuzoi si të pabazuar, duke konfirmuar se specifikat janë minimale dhe lejojnë ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar. Në pajtim me nenin 67.1 të RRPP-së (*res judicata*), si dhe me afatin prekluziv të nenit 60.1(a) të RRPP-së për kontestimin e dokumenteve të tenderit, ankuesi nuk mund ta rihapë në fazën e vlerësimit ligjshmërinë e një specifikimi të konfirmuar nga vetë OSHP-ja.

Së treti, ekspertiza private e angazhuar nga ankuesi pas pranimin të letrës së eliminimit dhe referencat në udhërrëfyesin e OBSH-së nuk e ndryshojnë gjendjen faktike as juridike të lëndës. Asnjëra prej tyre nuk e vërteton elementin e vetëm vendimtar – se produkti i ofruar e përmbush kërkesën minimale prej 89.1 g Etanol 96% në 100 g të fiksuar në Dosjen e Tenderit. Ato, në substancë, kontestojnë përshtatshmërinë e vetë kriterit, çështje kjo e pakohshme dhe e

konsumuar sipas arsyesimit më lart. Vlerësimi i ofertave bëhet ekskluzivisht ndaj kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit (neni 40.2 dhe 40.13 i RRPP-së), e jo ndaj provave *ex post* të palëve.

Së katërti, pranimi i një produkti nën minimumin e përcaktuar do të përbënte pikërisht atë që neni 40.2 i RRPP-së e ndalon shprehimisht – ndryshimin, modifikimin apo heqjen e kërkesave të përcaktuara paraprakisht gjatë vlerësimit – si dhe trajtim të pabarabartë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së ndaj operatorëve ekonomikë të cilët nuk ofertuan ose ofertuan me produkte më të kushtueshme pikërisht për ta përmbushur minimumin. Devijimi i konstatuar përbën largim thelbësor në kuptim të nenit 40.7, nënparagrafët (i) dhe (ii) të RRPP-së, pasi dallon esencialisht nga specifikimet e dosjes së tenderit dhe afekton cilësinë e ekzekutimit të kontratës. Rrjedhimisht, konstatimi i AK-së se oferta për pozicionin 68 është e papërgjegjshme është i drejtë dhe në pajtim me nenin 40.6(b) të RRPP-së.

Mendimi I ekspertit teknik: Pretendimi është i pabazuar. Eliminimi i ofertës në bazën teknike është i ligjshëm dhe i mjaftueshëm për refuzimin e ofertës në tërësi. Rrjedhimisht, ekspertet teknik i rekomandojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE "MEDPLUS SH.P.K." të REFUZOHET si e pabazuar sa i përket specifikave teknik ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigjet në pretendime ankimore teknike janë dhënë nga eksperti teknik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**MEDPLUS SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësore për Barnatoren Qendrore të QKMF-së**” me numër të prokurimit: “**635-26-957-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA E PEJES**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **MEDPLUS SH.P.K.**



Florije Rexhepi

Sezair Ruhani